PSH.nr.949/20
963/20
965/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi– Referues, Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë, dhe OE N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë, si dhe OE "GEOLAND" shpk-Prishtinë kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR , më datë: 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHEN</u>, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë, ankesa e operatorit ekonomik OE N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë, dhe ankesa e operatorit ekonomik OE "GEOLAND" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR.

II. <u>ANULOHET</u>, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë, OE N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë, si dhe OE "GEOLAND" shpk-Prishtinë aprovohen pjesërisht si të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr 949/20, kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 10, 27, 52, 59, 60, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 17.11.2020 me nr 963/20, kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 56, 59, 60, 62, 64, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 44.5 te RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues "GEOLAND" shpk-Prishtinë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.11.2020 me nr 965/20, kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e kontrollit dhe zhvillimit te kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore", me nr. të prokurimit: 203-20-3525-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MBPZHR, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 10, 59, 69, 72, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 03.12.2020 sqaron si në vijim

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Të dy kompanitë pjesëmarrëse ne konzorcium nuk e kanë sjellë vërtetimin e ATK-së dhe të Gjykatës Themelore.

Sa i përket arsyes se lartcekur te eliminimit te OE ankues, eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se ne sistemin e E-prokurimit, nuk ka vërejtur kërkesë nga ana e AK-se, qe i njëjti ka pranuar kërkesë për ti dorëzuar dokumentet/dëshmitë në fjale dhe njëherit eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit dhe dispozitat e nenit 26 te RrUOPP-se AK-ja, obligohet qe te ja kërkoj vetëm tenderuesit te cilin do ta rekomandoj për kontrate, ndërsa ne rastin konkrete AK-ja e ka anuluar ne tërësi aktivitetin e prokurimit ne fjale. Prandaj kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

- Njërit ekspert i mungon certifkata për analiza te imazheve satelitore.

Lidhur me mungesën e certifikatës se ekspertit për analiza te imazheve satelitore, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se i ka ofruar tre ekspert sipas kërkesën se dosjes se tenderit dhe për te njëjtit pretendon se i plotësojnë ne tërësi kërkesën e AK-se, me ç'rast ne ankese deklaron se certifikata është dorëzuar ne piken 18 te follderit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofertën e te tij OE ankues, lidhur me certifikatën e ekspertit për analiza te imazheve satelitore ka dorëzuar, nga tre ekspert te kërkuar, OE ankues nuk ka ofruar cerfikaten e Ongun Sumnulu për analiza te imazheve satelitore, por për te njëjtën AK-ja, është dashur te kërkojë sqarime lidhur me deshmit e ofruara për faktin se disa dëshmi janë te paqarta.

- Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë arsye te eliminimit sqaron se për ekspertin Abdullah Ekinci, OE ankues ka ofruar nje certifikat mirëpo e njëjta certifikat nuk përmban te dhëna te mjaftueshme për ta verifikuar se kush është lëshuesi i asaj certifikate dhe a është prodhues i dronit, pra kjo certifikate ka shume pak te dhëna, prandaj konform nenit 72 AK-ja, është dashur ta verifikoje.

- Njërit ekspert i mungon diploma master.

Sa i përket kësaj arsye te eliminimit eksperti shqyrtues, sqaron se për ekspertin e bujqësisë Yakup Ergun, OE ankues ka ofruar diplomen bachelor dhe nuk ka ofruar master siç është kërkuar ne dosje te tenderit.

- Mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore.

Sa i përket kontratës, lidhur me prodhuesin e imazheve satelitore, eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne deshmit e ofruara nga OE ankues, vlerëson se për te vlerësuar sakte kontratën me Mirë Geospatial, AK-ja, është dashur qe gjate vlerësimit te ofertave ti sqaroj disa paqartësi lidhur me kontratën për faktin se është i paqëndrueshëm pretendimi i AK-se, se nuk mund te vërtetohet se kjo kompani posedon sisteme satelitore për prodhim te imazheve.

- Mungon DUD-i doganor i dronit.

Po ashtu sa përket mungesës se DUD-it doganor, eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofertën e tij OE ankues ka ofruar mjaftueshëm dëshmi lidhur me dronin për faktin se ne kërkesë te dosjes se tenderit AK-ja ka kërkuar edhe fature si dëshmi te cilën e ka ofruar OE ankues dhe jo vetëm DUD- doganor.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me larte, vlerëson se OE ankues nuk i ka plotësuar ne tërësi kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Infratek":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Njërit OE deklaratën nen betim e ka nënshkruar një person i cili nuk posedon autorizim te noterizuar për përfaqësim te kompanisë.

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë pretendim, sqaron dhe vlerëson se nuk qëndron kjo arsye e eliminimit, për faktin se AK-ja, nuk ka kërkuar autorizim pre nënshkrim te dokumenteve dhe njeherit është ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se.

- Dy OE nuk kanë sjelle vërtetimin e Gjykatës Thelemore.
- Njeri OE nuk ka sjelle vërtetimin e ATK-se.

Sa i përket dy arsyeve te lartshënuara eksperti shqyrtues, vlerëson ngjashëm sikurse te OE ankues Mesicoglu Muhendislik, prandaj edhe kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

- Dy OE nuk kane sjelle certifikate te TVSH-se.

Sa i përket certifikatave te TVSH-se, te anëtareve te konzorciumit eksperti shqyrtues, vlerëson se te njëjtit e

ka dorëzuar ekstraktin e regjistrit tregtare, te cilin AK-ja është dashur ta verifikoje sakte pran organeve kompetente për faktin se behet fjale për operatore ekonomik te huaj dhe njeherit sqaroj se jo domosdoshmerishte një operator ekonomik duhet te pajiset me certifkate te TVSH-se edhe me legjislacionin tone, prandaj ka qene e nevojshme te verifikohet një pretendim i tille.

- Mungon diploma adekuate sipas kërkesës nr. 1 te kapacitetit teknik dhe profesional.

Eksperti shqyrtues, sqaron se sa i përket pikës nr. 1 te kapacitetit teknik dhe profesional, OE ankues ka ofruar projekt menaxherin Stefan Lang dhe për te njëjtin ka ofruar diplome si Gjeograf, ndërsa ne kërkesën nr. 1 te dosjes se tenderit është kërkuar qe menaxheri i projektit te jetë: Master i Shkencave të Gjeohapesires (Gjeomatikë , Hartografisë, Gjeoinformatikes ose Aeroinxhinierise), andaj shqyrtues, vlerëson se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit.

- Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit.

Sa i përket certifikatës se lartpërmendur, eksperti shqyrtues sqaron e OE ankues e ka dorëzuar certifikaten e ekspertit Lucijo Mrtinic e cila është lëshuar nga DPO Creë academy dhe te njëjtën thuhet se eksperti i lartpërmendur ka përfunduar trajnimin dhe i njëjti është pilot i dronit.

- Njërit ekspert i mungon diploma adekuate.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit te lartshënuar sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar Master te shkencave te tokës, ndërsa OE ankues ne ofertën e tij për ekspertin Vladimir Kusan ka dorëzuar diplomën me titull: Biotechnical Forestry, e cila ne vlerësimin e ekspertit nuk ka te beje me kërkesën e dosjes se tenderit.

- Grupi i OE-ve, nuk i përmbush kërkesën minimale prej 1,935,000.00€.

Eksperti shqyrtues, lidhur me kontratat dhe referencat e OE ankues sqaron se ne ofertën e tij i ka dorëzuar dy lista te kontratave ne te cilat i ka paraqitur edhe te dhënat e kontratave. Ne liste ne kontratave eksperti shqyrtues, ka vërejtur se OE ankues i ka përshkruar te njëjtat kontrata ne te dy listat dhe te njëjtat janë te papërfunduara te cilat nuk mund te merren parasysh. Po ashtu eksperti shqyrtues sqaron se gjate analizimit te kontratave dhe referencave te cilat i ka bashkangjitur OE ankues, ka vërejtur se i njëjti ka dorëzuar ne gjuhen Sllovene, Kroate te cilat janë ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se dhe po ashtu ka mospërputhje te datave te paraqitura ne liste ne kontratave dhe datave te paraqitura ne kontrate dhe referenca.

Prandaj eksperti shqyrtues, vlerëson se për te konstatuar se a e përmbush këtë kërkesë OE ankues, është dashur fillimisht AK-ja, përkatësisht komisioni vlerësues ti verifikoje me ne detaje kontratat dhe po ashtu fakti qe nuk bane ne njërën nga gjuhet zyrtare sipas nenit 13 te LPP-se, nuk mund te nxirret një konstatim i sakte.

- Mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore.

Sa i përket kontratës me prodhuesin e imazheve satelitore, eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për faktin se AK-ja, ka kërkuar dëshmi se: OE duhet te dëshmojë qe posedon

sisteme satelitore për fotografim me rozulucion prej 50cm ose me te mire. OSE, është i autorizuar nga prodhuesi i imazheve satelitore. Ne rsatin konkrete OE ankues nuk ka ofruar dëshmi se e posedon sistemin për prodhimin e imazheve satelitore, ndërsa sa i përket pjesës se dyte te kësaj kërkesë ku AK-ja, e jep mundësinë (OSE, është i autorizuar nga prodhuesi i imazheve satelitore) qe ne rast se nuk e posedon sistemin e imazheve satelitore atëherë mund te sjell si dëshmi autorizimin nga prodhuesi i imazheve satelitore, dhe ne rastin konkrete OE ankues e dëshmon me autorizim te lëshuar nga Vekom i cili është distributore i autorizuar nga European Space Image dhe te njëjtin fakt e pranon edhe vet operatori ekonomik ne ankese se nuk e ka nga prodhuesi por nga distributori i autorizuar.

- Konzorciumi nuk posedon dron – por e ka marr ne shfrytëzim.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e AK-se, se OE ankues nuk e ka ne pronësi dronin, nuk qëndron, për faktin se OE ankues ka ofruar dëshmi – fature e cila është ne emër te OE Oikon (anëtare i konzorciumit) dhe ne rastin konkrete AK-ja, është dashur ta vlerësoj sipas paragrafit 4 te nenit 71 te LPP-se, ndërsa sa i përket dyshimeve te AK-ja, se i njëjti e ka marr ne shfrytëzim nga Universiteti i Zagrebit dhe nuk është ne pronësi te OE ankues një gjë te tille është dashur ta verifikoje, për faktin se siç u sqarua edhe me larte ne oferte ekziston je fature e dronit e cila dëshmon se është ne pronësi te OE Oikon.

OE ankues ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya, i cili është me çmim me ulet, dhe për te njëjtin pretendon se është i papërgjegjshëm, eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues, qe kanë te bëjnë me ofertën e te OE te lartpërmendur ka dhenë sqarime me larte sepse pretendimet e OE ankues janë edhe arsyet e eliminimit te OE Mesicoglu nga ana e AK-se dhe për te njëjtin është konstatuar se nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Geo Land":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Grupi i OE-ve, nuk e përmbush kërkesën minimale prej 1,935,000.00€, për tri vitet e fundit prej datës se publikimit te njoftimit per kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues lidhur me arsyen eliminimit pretendon se kërkesa e AK-se, nuk e specifikon periudhën kohore prej 3 vitesh, andaj pretendon se i njëjti e ka plotësuar kërkesën e AK-se lidhur me kontratat dhe referencat.

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues, sqaron se ne sistemin e e-prokurimit, AK-ja, me datën 13.08.2020, ka publikuar njoftimin për përmirësim te informatave dhe ne kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat ka kërkuar:

Dëshmia 7: OE duhet të ofroj listën e projekteve për tri vitet fundit para publikimit te njoftimit, ku duhet të ceket Autortiteti Kontraktues, vlera e projekti, data e realizimit të projektit bashkangjitur duhet të ketë

referencat për shërbimet punët e realizuara.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne listën e kontratave dhe referencave vlerëson se OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me kontratat dhe referencat dhe vlera arrin shifrën afër 1,000,000.00€, ndërsa një numër i madh i kontratave te prezantuara ne listën e kontratave, janë para datës se publikimi te njoftimit për kontrate.

Lidhur me këtë ceshtje OE ankues pretendon se oferta jone mbështetet ne grup te OE-ve si dhe ne kapacitetet e subjekteve tjera (AIRBUS DS), me te cilën e tejkalon shume here vlerën e kërkuar nga AK-ja.

Eksperti shqyrtues, sqaron se kontrata me Airbus, nuk mund te merret parasysh për faktin se nuk ka marrëveshje konzorciumi me këtë operator ekonomik dhe sipas procesverbalit te hapjes janë Geo Land dhe Geo Map. Prandaj eksperti shqyrtues, vlerëson se me te drejte AK-ja e ka eliminuar.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, lidhur me kerkesen për qasjen ne dokumentacion zyrtare, për te cilën OE ankues pretendon se ka kërkuar qasje dhe se AK-ja, nuk i ka ofruar qasjen dokumente, eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron ky pretendim për faktin se ne sistemin e e-prokurimit nuk ka gjetur aprovim te kërkesës se OE ankues dhe njeherit sqaroj se kjo konsiderohet shkelje procedurale.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me larte, vlerëson se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues, ne fund ta analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore dhe arsyeve te eliminimit, sqaron se OE-te ankues, nuk i kanë plotësuar ne tërësi kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Mendimi i ekspertes shqyrtuese: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues te aprovohen si pjesërisht e te bazuara, ndërsa vendimi i AK-së për anulim te aktivitetit te prokurimit te mbetet ne fuqi.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 04.12.2020 ka njoftuar OSHP-në se PAJTOHET me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Operatori ekonomik "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë nuk ka përgjigje

Operatori ekonomik N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë përmes parashtresës me shkrim të datës 07.12.2020 ka njoftuar OSHP-në se NUK PAJTOHET me raportin e ekspertes shqyrtuese.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr.963/20 TË DT.03.12.2020

Ne konfirmojmë pranimin e ekspcrtizës Nr.963/20 të dt.03.12.2020 dhe në vazhdim po i japim përgjigjet lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues. .

Pajtohcm me konstatimet **nr. 1,2, 5, 9 dhe 10** të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet tona ankimore.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.3** të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se në lidhje me pretendimin e AK-së se kinse dy anëtarët e konzorciumit nuk i kanë dorëzuar certifikatat e TVSH, AK-ja është dashur të verifikoj pretendimin tonë, ju sqarojmë se konstatimi i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se të dy anëtarët e konzorciumit e kanë dorëzuar dokumentacionin ligjor provues "Ekstraktin e Regjistrit Tregëtar" të lëshuar nga organet kompetente të vendit të tyre të origjinës, i cili përmban numrin e regjistrimit të shoqërisë dhe numrin e TVSH-së, ku me këto dëshmi përmbushet kërkesa e AK-së. Mirëpo ne e kemi cekur shumë qartë se edhe kur mungon certifikata e TVSH lejohen të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 39 të RRUOPP, dhe nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, prandaj për çdo paqartësi mund të shfrytëzohen këto dispozita ligjore.

Andaj eksperti shqyrtues është dashur ta cilësojë pretendimin tonë ankimor të bazuar, pa kërkuar fare verifikim nga ana e AK-së.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.4** të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se kinse ne nuk e kemi plotësuar kërkesën 1 tek kapaciteti teknik dhe profesional dhe se projekt menaxheri i prezantuar nuk është master i shkencave të gjeohapsirës. Ju sqarojmë se konslatimi i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se ne e kemi prezantuar për pozicionin e Mcnaxherit të Projektit Z. Stefan Lang, i cili shihet qartë se posedon Diplomën me Doktoraturën në Shkenca Natyrore- Gjeografi që përmban fushat *"Remote Sensing; Landscape ecology"*; Diplomë Masteri në Gjeografi që përmban fushat " *Comparative cultural and social geography; Applied landscape ecologie"* Diplomë në Gjeografi që përmban fushat *"Remote Sensing; Landscape ecology"*, pra diploma e prezantuar nga ana jonë në lidhje me menaxherin e lartcekur shihet qartë se e përmbush kërkesën c FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, madje ky person është i mbi kualifikuar. Andaj konstatimi i ekspertit shqyrtucs është i pa bazuar pasi që nuk i ka analizuar në tërësi diplomat e prezantuara nga ne, ose nuk i ka pas të qarta këto dëshmi dhe me këtë rast është bazuar në arsyetimin e AK-së për eliminimin tonë.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.6** të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se kinse diploma e prezantuar nga ne për ekspertin Vladimir Kusan nuk ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit. Ju sqarojmë se ky konstatim i ekspertit shqyrtues është tërësisht i pa bazuar, për faktin se ne kemi prezantuar për pozicionin e Ekspertit të Bujqësisë, një ekspert që zotëron Diplomë në *"Biotechnical Forestry"*, e cila bën pjesë në shkencal e tokës dhe plotëson tërësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 të dosjes se tenderit. Ndërsa është për tu veçuar eksperienca e gjerë profesionale e tij në analizën e të dhënave të kulturave bujqësore.

Andaj duke u bazuar në faktct e lartcekura, shihet qartë se eksperti i prezantuar nga ne i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj edhe konstatimi i ekspertit shqyrtues në lidhje me ekspertin e lartcekur është i pa bazuar, pasi që nuk i ka analizuar në tërësi dëshmitë e prezantuara nga ne por ka bërë më shumë shqyrtim sipërfaqësor të pretendimeve tona.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.7** të ekspertit shqyrtues në lidhje me kriterin minimal prej 1,935,000.00 €, ku ka konstatuar se, a është përmbushur apo jo kjo kërkesë AK-ja është dashur ti verifikojë në detaje kontratat dhe se fakti që këto kontrata nuk janë në njërën nga gjuhet zyrtare sipas nenit 13 të LPP-së, nuk mund të nxirret një konstatim i saktë. Ju sqarojmë se ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se mjafton vetëm ti referohemi disa projekteve në mënyrë nominative dhe rezulton se vlera e shërbimeve të ngjashme, jo vetëm që plotësohet vlera e kërkuar në dosje të tenderit por tejkalohet disa herë. Mirëpo nga ky konstatim i ekspertit shqyrtues vërehet se nuk janë shqyrtuar në detaje pretendimet tona dhe dëshmitë tona të ofruara për ti analizuar kontratat e prezantuara nga ne, prandaj në rast se ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me këto kontrata ka mundur të na kërkojë sqarime dhe ne do ti i kishim ofruar ato.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.8** të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se kinse ne nuk kemi ofruar dëshmi se e posedojmë sistemin për prodhimin e imazheve satelitore, ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se ne si grup i OE "N.T.SH. Infratek dhe Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o" kemi prezantuar një kontratë me palën Abkons shpk dhe Vekom", ku ky i fundit është **Subjekt i autorizuar i European Space Image.** Pra ne si grup i OE e plotësojmë kërkesë ne dosjes së tenderit.

Ndërsa sa i përket konstatimit tjetër te ekspertit shqyrtues ku e ka cekur se kinse ne vet e kemi pranuar se nuk e kemi autorizimin nga prodhuesi por nga distributori i autorizuar. Ne jemi të habitur se si ka ardhe në një përfundim të tillë eksperti shqyrtues, pasi që vetë **Vekoni** është subjekt i autorizuar i European Space Image, mirëpo ne përveç kontratës e kemi bashkangjitur edhe shkresën mbështetëse që tregon qartë se Abkons si **klient i Vekom** mbështetet në këtë pjesë të veprimtarisë nga European Space Image. Pra është shumë e qartë se Vekom është distributor i autorizuar i imazheve satelitore në Ballkan, të prodhuara nga European Space Image dhe ja mbështetje të plotë nga uropean Space Image . Andaj konslatimi i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe njëkohësisht absurd dhe është vetëm mbështetje e plotë e njoftimil mbi vendimin e AK-së.

Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë, prandaj lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik "GEOLAND" shpk-Prishtinë përmes parashtresës me shkrim të datës 07.12.2020 ka njoftuar OSHP-në se NUK PAJTOHET me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Konfirmojme pranimin e emailit. NUK PAJTOHEMI ME MENDIMIN E EKSPERTIT SHQYRTUES.

Sqarojmë panelin e nderuar se per piken e vetme te diskutueshme nga eksperti shqyrtues (Deshmia 7) ne lidhje me kontratën e bashkëpunimit te lidhur me AIRBUS DS, ne kemi pranuar interpretim ligjor nga ana e KRPP e cila e vlerëson këtë marrëveshje ne përputhje me LPP. Andaj do ti ri përsërisim Kontratën, marrëveshjen e bashkëpunimit dhe Referencat ashtu siç i kemi dorëzuar te cilat shumëfish e tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 1,935.000.00eur

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor si në vijim:

Paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së lidhur me **Aftësitë teknike dhe/ose profesionale**, përcakton:

"8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera".

Në përputhje me dispozitën e lartë cituar, çdo Operator Ekonomik i cili nuk mund t'i përmbushë si i vetëm kërkesat e parashtruara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë lidhur me **aftësitë teknike dhe/ose profesionale,** mund të mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër. Në këtë rast **OE duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës.**

Përveç **kërkesës** së dispozitës në fjalë që OE ***"të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës",*** se cilat dëshmi mund të ofrohen me tender nga OE, nuk përcaktohet me dispozitën e lartë cituar.

Megjithatë **OPINIONI** i KRPP-së është se OE mund të dëshmojë për autoritetin kontraktues për shembull me një **Marrëveshje me shkrim** me subjektin tjetër që i ofron mbështetjen.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 18.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit,

ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya", se është eliminuar nga AK me arsyetimin se: të dy kompanitë pjesëmarrëse në konzorcium nuk e kanë sjellë vërtetimin e ATK-së dhe të Gjykatës Themelore.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues për këtë arsye të eliminimit sqaron se në sistemin e E-prokurimit, nuk ka vërejtur kërkesë nga ana e AK-së që i njëjti ka pranuar kërkesë për ti dorëzuar dokumentet/dëshmitë në fjale dhe njëherit Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit dhe dispozitat e nenit 26 të RrUOPP-së, sqaron se AK-ja obligohet që ta kërkoj vetëm nga tenderuesi të cilin do e rekomandoj për kontratë. Ndërsa në rastin konkret AK-ja e ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit në fjalë. Prandaj kjo arsye e eliminimit nuk qëndron dhe ky pretendim ankimor është i bazuar.

- Njërit ekspert i mungon certifikata për analiza te imazheve satelitore.

Lidhur me mungesën e certifikatës se ekspertit për analiza të imazheve satelitore, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se i ka ofruar tre ekspert sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe për të njëjtit pretendon se i plotësojnë në tërësi kërkesën e AK-së, me ç' rast në ankesë deklaron se certifikata është dorëzuar në piken 18 të follderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën e OE ankues, lidhur me certifikatën e ekspertit për analiza të imazheve satelitore ka dorëzuar nga tre ekspert të kërkuar, OE ankues nuk ka ofruar certifikatën e Ongun Sumnulu për analiza të imazheve satelitore, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, lidhur me ketë arsye të eliminimit sqaron se për ekspertin Abdullah Ekinci, OE ankues ka ofruar një certifikatë mirëpo e njëjta certifikatë nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për ta verifikuar se kush është lëshuesi i asaj certifikate dhe a është prodhues i dronit, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

- Njërit ekspert i mungon diploma master.

Sa i përket kësaj arsye te eliminimit eksperti shqyrtues, sqaron se për ekspertin e bujqësisë Yakup Ergun, OE ankues ka ofruar diplomën bachelor dhe nuk ka ofruar master siç është kërkuar në dosje të tenderit ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

- Mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore.

Sa i përket kontratës, lidhur me prodhuesin e imazheve satelitore, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga OE ankues, vlerëson se për të vlerësuar saktë kontratën me Mirë Geospatial, AK-ja

është dashur që gjatë vlerësimit të ofertave ti sqaroj disa paqartësi lidhur me kontratën për faktin se është i paqëndrueshëm pretendimi i AK-së, se nuk mund të vërtetohet se kjo kompani posedon sisteme satelitore për prodhim të imazheve dhe ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Mungon DUD-i doganor i dronit.

Po ashtu, sa përket mungesës së DUD-it doganor, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën e tij OE ankues ka ofruar mjaftueshëm dëshmi lidhur me dronin për faktin se në kërkesë të dosjes së tenderit AK-ja ka kërkuar edhe faturë si dëshmi të cilën e ka ofruar OE ankues dhe jo vetëm DUD- doganor. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna më lartë, vlerëson se OE ankues nuk i ka plotësuar në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Infratek"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Njërit OE deklaratën nen betim e ka nënshkruar një person i cili nuk posedon autorizim te noterizuar për përfaqësim te kompanisë.

Paneli Shqyrtues sqaron se AK eshte dashur te kërkoj sqarime shtese lidhur me kete pike, pra ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Dy OE nuk kanë sjelle vërtetimin e Gjykatës Thelemore.
- Njeri OE nuk ka sjelle vërtetimin e ATK-se.

Sa i përket dy arsyeve të lartshënuara, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson ngjashëm sikurse te OE ankues Mesicoglu Muhendislik, prandaj edhe kjo arsye e eliminimit nuk qëndron. pra ky pretendim ankimor është i bazuar.

- Dy OE nuk kane sjelle certifikate te TVSH-se.

Sa i përket certifikatave të TVSH-së, të anëtareve te konzorciumit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se të njëjtit e ka dorëzuar ekstraktin e regjistrit tregtar, të cilin AK-ja është dashur ta verifikoj saktë pranë organeve kompetente për faktin se bëhet fjalë për operator ekonomik të huaj dhe njëherit jo domosdoshmërisht një operator ekonomik duhet të pajiset me certifikatë të TVSH-së edhe me legjislacionin tonë. Prandaj, ka qenë e nevojshme të verifikohet një pretendim i tillë.

- Mungon diploma adekuate sipas kërkesës nr. 1 te kapacitetit teknik dhe profesional.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se sa i përket pikës nr. 1 te kapacitetit teknik dhe profesional, OE ankues ka ofruar projekt menaxherin Stefan Lang dhe për të njëjtin ka ofruar diplomë si Gjeograf, ndërsa në kërkesën nr. 1 të dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit te jetë: Master i Shkencave të Gjeohapesires (Gjeomatikë, Hartografisë, Gjeoinformatikes ose Aeroinxhinierise), andaj OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit.

- Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit.

Sa i përket certifikatës së lartpërmendur, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron e OE ankues e ka dorëzuar certifikatën e ekspertit Lucijo Mrtinic e cila është lëshuar nga DPO Crew academy dhe të njëjtën thuhet se eksperti i lartpërmendur ka përfunduar trajnimin dhe i njëjti është pilot i dronit.

- Njërit ekspert i mungon diploma adekuate.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit të lartshënuar sqaron se AK-ja, në dosje të tenderit ka kërkuar Master të shkencave të tokës, ndërsa OE ankues në ofertën e tij për ekspertin Vladimir Kusan ka dorëzuar diplomën me titull: Biotechnical Forestry, e cila nuk ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit.

- Grupi i OE-ve, nuk i përmbush kërkesën minimale prej 1,935,000.00€.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, lidhur me kontratat dhe referencat e OE ankues sqaron se në ofertën e tij i ka dorëzuar dy lista të kontratave në të cilat i ka paraqitur edhe te dhënat e kontratave. Në listën e kontratave, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se është vërejtur se OE ankues i ka përshkruar të njëjtat kontrata në të dy listat dhe të njëjtat janë të papërfunduara të cilat nuk mund të merren parasysh. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë analizimit të kontratave dhe referencave të cilat i ka bashkangjitur OE ankues, ka vërejtur se i njëjti ka dorëzuar në gjuhen Sllovene, Kroate të cilat janë në kundërshtim me nenin 13 të LPP-së dhe po ashtu ka mospërputhje të datave të paraqitura në listë të kontratave dhe datave të paraqitura në kontrate dhe referenca.

Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, vlerëson se për të konstatuar se a e përmbush këtë kërkesë OE ankues, është dashur fillimisht AK-ja, përkatësisht komisioni vlerësues ti verifikoj më në detaje kontratat dhe po ashtu fakti që nuk bënë në njërën nga gjuhet zyrtare sipas nenit 13 të LPP-së, nuk mund të nxirret një konstatim i saktë.

- Mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore.

Sa i përket kontratës me prodhuesin e imazheve satelitore, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, vlerëson se OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për faktin se AK-ja ka kërkuar dëshmi se: OE duhet te dëshmojë qe posedon sisteme satelitore për fotografim me rozulucion prej 50cm ose me te mire. OSE, është i autorizuar nga prodhuesi i imazheve satelitore. Në rastin konkret, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi se e posedon sistemin për prodhimin e imazheve satelitore, ndërsa sa i përket pjesës së dytë të kësaj kërkesë ku AK-ja, e jep mundësinë (OSE, është i autorizuar nga prodhuesi i imazheve satelitore) që në rast se nuk e posedon sistemin e imazheve satelitore atëherë mund të sjell si dëshmi autorizimin nga prodhuesi i imazheve satelitore, dhe ne rastin konkrete OE ankues e dëshmon me autorizim te lëshuar nga Vekom i cili është distributore i autorizuar nga European Space Image dhe të njëjtin fakt e pranon edhe vet operatori ekonomik në ankesë se nuk e ka nga prodhuesi por nga distributori i autorizuar pra ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

- Konzorciumi nuk posedon dron – por e ka marr ne shfrytëzim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e AK-se, se OE ankues nuk e ka në pronësi dronin, nuk qëndron për faktin se OE ankues ka ofruar dëshmi – faturë e cila është në emër të OE Oikon (anëtar i konzorciumit) dhe në rastin konkrete AK-ja është dashur ta vlerësoj sipas LPP-se, ndërsa sa i përket dyshimeve të AK-së, se i njëjti e ka marr në shfrytëzim nga Universiteti i Zagrebit dhe nuk është në pronësi të OE ankues, një gjë të tillë është dashur ta verifikoje, për faktin se siç u sqarua edhe më larte, në ofertë ekziston një fature e dronit e cila dëshmon se është në pronësi të OE Oikon.

OE ankues në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya, i cili është me çmim më ulët dhe për të njëjtin pretendon se është i papërgjegjshëm, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues, që kanë të bëjnë me ofertën e OE të lartpërmendur ka dhënë sqarime më lartë sepse pretendimet e OE ankues janë edhe arsyet e eliminimit të OE Mesicoglu nga ana e AK-së, dhe për të njëjtin është konstatuar se nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Geo Land"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Grupi i OE-ve, nuk e përmbush kërkesën minimale prej 1,935,000.00€, për tri vitet e fundit prej datës se publikimit te njoftimit per kontrate.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues lidhur me arsyen eliminimit pretendon se kërkesa e AK-së, nuk e specifikon periudhën kohore prej 3 vitesh, andaj pretendon se i njëjti e ka plotësuar kërkesën e AK-se lidhur me kontratat dhe referencat.

Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik ankues ne ofertën e tije ka te bashkangjitura disa referenca ku vetëm po e përmendim referencën e datës 04.08.2020 me numër 3149 te lëshuar dhe protokolluar nga vet Autoriteti Kontraktues – Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ne vlere prej 1,494,490.00 €.

Kërkesa ne dosje te tenderit është si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 7 OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 3 kontrata të natyrës së ngjashme nga fusha e bujqësisë ose zhvillimit rural, në vlerë jo më pak se 2,500,000 € te gjitha.**

Dëshmia e kërkuar dokumentare **Dëshmia 7 OE duhet të ofroj listën e projekteve të realizuara te natyrës sipas pikës 2, ku duhet të ceket Autortiteti Kontraktues, vlera e projekti, data e realizimit të projektit bashkangjitur duhet të ketë referencat për shërbimet punët e realizuara.**

Autoriteti Kontraktues nëse ka dilema lidhur me këtë pike te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72

te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues ne Dosje te tenderit tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1 Qarkullimi vjetor në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrate jo me pak se 750,000 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Vërtetimi nga banka ne origjinal dhe dëshmimi mund të ofrohet edhe përmes institucioneve tjera te përcaktuar me LPP.

Sipas kërkesës se me sipërme Autoriteti Kontraktues nuk e ka limituar Kohen se prej kur duhet te dorëzohen referencat gjithashtu siç shihet vet kërkesat e Autoritetit Kontraktues janë kontradiktore pasi qe është dashur te kërkohet edhe qarkullimi me vlere me te larte se vlera e kontratave ku gjate fazës se sqarimit te tenderëve kemi këtë sqarim nga AK:

Pyetje OE:

1.Kërkesa 1 Qarkullimi vjetor në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrate jo me pak se 750,000 €. Ju lutem na sqaroni nëse kërkesa ka te beje për qarkullim brenda 1 viti ne vlere 750,000 €, qe i bie për 3 vite në vlerë total 2,250,000 €; apo për tre vitet se bashku ne vlerën 750,000 €?

Përgjigje AK:

Qarkullimi qe kemi kërkuar ne si AK-se është 750,000 € për tri vitet e fundit.

Autoriteti Kontraktues duhet te beje vlerësimit e Ofertave per këtë pike sipas kërkesave te vendosura ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrate nga vet AK gjithashtu te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se lidhur me këtë pike ankimore te OE ankues.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me kërkesën për qasjen në dokumentacion zyrtar, për te cilën OE ankues pretendon se ka kërkuar qasje dhe se AK-ja, nuk i ka ofruar qasjen dokumente, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se qëndron ky pretendim për faktin se në sistemin e e-prokurimit nuk ka gjetur aprovim të kërkesës se OE ankues dhe njëherit kjo konsiderohet shkelje procedurale.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "MBPZHR";

1x1 OE "Mesicoglu Muhendislik ve Musavirlik & Urban Metropol & Cankaya"-Prishtinë;

1x1 OE N.T.SH "INFRATEX"- Prishtinë;

1x1 OE "GEOLAND" shpk-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.